



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



PROJEKT BUXHETI I KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN 2021

Gjakovë, 2020

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	3
Korniza e përgjithshme	3
KORNIZA FISKALE	4
PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE	5
BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2021	5
Burimet e financimit komunal për vitin 2021	5
Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2021-2023	7
Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2021-2023	9
Struktura e Buxhetit për vitin 2021	10
PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)	<u>14</u>

HYRJE

Korniza e përgjithshme

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021 – 2023 si dokument i rëndësishëm dhe më kryesor paraqet koherencën, koordinimin dhe ndërlidhjen funksionale në mes të prioriteteve të përcaktuara me dokumentet strategjike komunale për zhvillim në njërin anë si dhe përfshirjen e tyre konkrete e specifike në projeksionet buxhetore për periudhën afatmesme. Duke u bazuar në këto premisa themelore që përfshijnë aspektet e menaxhimit të financave publike, ato fiskale, ekonomike e shoqërore është konceptuar edhe Deklarata e Prioriteteve të Qeverisë komunale komfor Strategjisë komunale për zhvillim.

Prioritetet e Qeverisë Komunale të Gjakovës si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në nivel të Republikës së Kosovës: 2021 – 2023, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, infrastrukturës komunale, sektorit të arsimit, kulturës, rinisë dhe sporteve, sektorin e shëndetësisë primare, atë të bujqësisë, mjedisit etj. Prioritetet afatmesme 2021 - 2023, bazohen në Programin e Punës së Qeverisë Komunale dhe prioritetet e saj dhe Strategjinë e Zhvillimit Socio – Ekonomik Lokal për këtë periudhë.

Me Qarkoren e parë buxhetore nr.2021/01, të datës 15.05.2020 të lëshuar nga ana e MF-, janë caktuar limitet buxhetore për Komuna për periudhën 3 vjeçare: 2021 – 2023 në mesin e të cilave edhe për Komunën e Gjakovës .

Në procesin e realizimit të prioriteteve të Qeverisë Komunale rëndësi e veçantë i kushtohet qëndrueshmërisë buxhetore dhe projeksioneve makro – fiskale për periudhën afatmesme. Në këtë drejtim do të punohet që të vazhdohet me ritmin e ngritjes së vazhdueshme të investimeve kapitale, pastaj të ruhet stabiliteti buxhetor, ngarkesë të ulët të biznesit me tatime si dhe rritja e nivelit të grumbullimit të hyrave vetanake.

Komuna e Gjakovës si mision të vetin ka zhvillimin më të shpejtuar ekonomik të saj sipas prioriteteve të Strategjisë Komunale për Zhvillim Ekonomik të Komunës, duke siguruar ambient të sigurt dhe tërheqës për investitorët. Do të inkurajojë, mbështesë, bashkërendojë dhe koordinojë me efikasitet politika, aktivitete e burime që i kontribuojnë prosperitetit e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Komunës, fuqizimit të biznesit dhe sipërmarrjes, për një mirëqenie më të lartë njerëzore. Misioni i Qeverisë komunale për periudhën afatmesme buxhetore, është përsheptimi i ritmeve të zhvillimit ekonomik, shtimin e mundësive për shkollim, avancim të llojit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, kulturën, rininë dhe sportin, lëmin e bujqësisë si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe infrastrukturës komunale si çështje më kryesore që mund të ndikojnë për përmirësimin e shpejtë të gjendjes ekonomike e shoqërore të banorëve të Komunës.

KORNIZA FISKALE

Ndonëse Komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Buxheti Komunal i Gjakovës është në përputhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës dhe me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Financimi komunal nga grantet qeveritare për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitin 2022 dhe 2023 përfshirë të hyrat vetanake komunale.

Nga aspekti i kornizës së re ligjore, sistemi i financimit komunal ka pësuar reforma progresive përkatësisht ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2021, si dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Sistemi aktual i financave komunale përbën decentralizimin fiskal të avancuar, komunat kanë kompetenca të konsiderueshme për shpenzimet, kompetenca për ofrim të shërbimeve publike, autorizime për mbledhjen e të hyrave, dhe autoritet të gjerë në menaxhimin e financave publike.

Përkushtimi i përgjithshëm për të përmirësuar elementet kyçe të procesit të zhvillimit të buxhetit, ka kërkuar edhe disa ndryshime në formatin e prezantimit të buxhetit komunal. Prandaj, jemi mbështetur në aspektet kryesore të mëposhtme të procesit buxhetor:

- Shfrytëzimi i Buxhetimit në nivel të programit dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të regjistrit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxheti mit të orientuar drejt rezultateve; dhe
- Zbatimi i konceptit mbi planifikimin shumëvjeçar të buxhetit / kapitaleve dhe prezantimi i të gjitha zërave të buxhetit për vitin paraprak, vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese.

Futja në përdorim e Buxhetimit kapital shumëvjeçar, përfshirë këtu integrimin e informatave për rezultatet e planifikuara në sistemin e PIP-it. Gjatë këtij viti komunat do të hartojnë për secilin program strategjinë me synimet dhe objektivat, përfundimet dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes procesit buxhetor.

PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE

Sipas Qarkores së dytë buxhetore nr. 2021/02 për Komuna të datës 10.08.2020 dhe në bazë të shënimeve statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, rrjedhë se komuna e Gjakovës ka 94,556 banorë, dhe nga Komisioni i Granteve – MF për vitin 2021 Komunës sonë iu është ndarë Grant Qeveritar 22,952,322.00 €.

Tabela nr. 1. Krahasimi i Buxhetit 2020/2021

Nr.	Përshkrimi	Vlera
	Buxheti komunal 2020 (aktual)	27,252,717.00
	Buxheti i propozuar 2021	26,330,580.00
	Ndryshimi	- 922,137.00

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2021/02, MF 2020

BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2021

Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhdimit të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2021 është planifikuar dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve buxhetore. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Prioritet për financim kanë projektet që janë të vazhdueshme që kanë filluar në vitet e mëparshme dhe atyre që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

Burimet e financimit komunal për vitin 2021

Financimi komunal përfshinë: grantet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFPP të dakorduar me Misionin e FMN-së.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifatat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.


Sipas Qarkores se parë dhe te dyte buxhetore të lëshuar nga ana e MF-it për periudhën 2021-2023 për Komunën e Gjakovës është caktuar për financimin e shpenzimeve 3 vjeçare si në tabelën 2.

Tabela nr.2. Totali i Burimeve te financimit komunal për vitet: 2021-2023

Kategoritë BUXHETORE - Burimet e financimit		2020	2021	2022	2023
		Aktual	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1	Granti i Përgjithshëm	10,133,611.00	9,415,942.00	9,894,565.00	10,363,762.00
2	Granti specifik i Arsimit	9,791,094.00	10,137,179.00	11,031,088.00	11,077,510.00
3	Granti specifik i Shëndetësisë	3,489,702.00	3,283,258.00	4,852,885.00	4,877,150.00
4	Të hyrat vetanake komunale	3,722,367.00	3,378,258.00	3,961,171.00	4,233,667.00
5	Financimi për teatro	115,943.00	115,943.00		
TOTALI:		27,252,717.00	26,330,580.00	29,739,709.00	30,552,089.00

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2021/01, MF 2020

Grafiku i trendit të buxhetit komunal 2021-2023



Burimi: Qarkorja Buxhetore 2021/02, MF 2020

Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2021-2023

Përveç Granteve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e mbulimit të shpenzimeve të përgjithshme, Komuna mbledh edhe të hyra vetanake. Të hyrat vetanake në Komunën e Gjakovës realizohen në bazë të Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Me Qarkoren buxhetore nr. 2021/01, për komunën e Gjakovës, për vitet: 2021 – 2023 është përcaktuar Planin i të hyrave vetanake si vijon:

- Viti 2021 3,378,258.00€,
- Viti 2022 3,961,171.00 €,
- Viti 2023 4,233,667.00 €.

Në tabelën e bashkangjitur në vijim është i përfshirë planifikimi i të hyrave vetanake komunale nga Drejtoritë që participojnë në realizimin e të hyrave vetanake.

Tabela nr. 3. Planifikimi i të hyrave vetanake për vitet 2021 – 2023

Kodet	BURIMI I TË ARDHURAVE	2021 Planifikimi	2022 Planifikim	2023 Planifikim
1	Administrata e përgjithshme	150,000.00	151,800.00	151,870.00
50013	Certifikatat e lindjes	98,000.00	100,000.00	100,020.00
50014	Certifikatat e kurorëzimit	20,000.00	20,000.00	20,010.00
50015	Certifikatat e vdekjes	5,500.00	4,500.00	4,510.00
50016	Certifikatat e tjera	7,500.00	7,800.00	7,810.00
50017	Taksa të verifikimit të dokumenteve të ndryshme	19,000.00	19,500.00	19,520.00
2	Drejtoria e Inspeksionit	80,000.00	73,000.00	79,114.00
50505	Dënimet nga Inspeksioni	17,000.00	12,000.00	18,010.00
50507	Leje për plotësimin e kushteve sanitare teknike	39,000.00	36,000.00	36,080.00
50211	Taksa për shërbimin e pijeve alkoolike	24,000.00	25,000.00	25,024.00
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1,929,530.00	2,532,538.00	2,706,747.00
50408	Qiraja për lokalet e komunës	50,000.00	56,782.00	60,500.00
40110	Tatimi mbi pronën	1,434,265.00	1,881,247.00	2,033,849.00
50001	Taksa për regjistrimin e automjeteve	150,000.00	160,000.00	159,000.00
E re	Tatimi në tokë dhe mbledhja e borgjeve	295,265.00	434,509.00	453,398.00
4	Drejtoria e Shërbimeve Publike	60,000.00	62,200.00	76,230.00
50103	Sekuestrimi i automjeteve		-	-
50008	Të hyrat nga parkingjet	25,000.00	26,000.00	30,000.00
50005	Taksa për leje vozitje - autobusëve	5,000.00	5,200.00	5,210.00
50406	Të hyrat nga tregjet	30,000.00	30,500.00	40,510.00
50401	Shitja e makinave		500.00	510.00
5	Drejtoria e Agrikulturës	50,000.00	41,220.00	51,230.00
50012	Shndërrimi i tokës bujqësore në jo - bujqësore	48,000.00	39,100.00	49,100.00
	Shitja e drunjëve të konfiskuar	2,000.00	2,120.00	2,130.00
6	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	80,000.00	71,000.00	81,100.00
50204	Leje - Taksa mbi firmën e biznesit	68,000.00	58,500.00	68,550.00
50221	Leje - Taksa për zgjatjen e orarit të punës	12,000.00	12,500.00	12,550.00
7	Kadastra	160,000.00	162,000.00	162,080.00
50504	Të hyrat nga shërbimet kadastrale	160,000.00	162,000.00	162,080.00
50503	Të hyrat nga Ekspertiza		-	-
8	Drejtoria e Urbanizmit	538,728.00	535,770.00	593,596.00
50009	Lejet e ndërtimit - (Taksa administrative dhe Tarifa rregullative për rritjen e densitetit)	417,626.00	411,270.00	468,796.00
50011	Taksat komunale: Pëlqimet e ndryshme, ndarjet fizike, ekstraktet nga planet, lejet dhe pëlqimet për objektet e infrastrukturës dhe taksa nga leja mjedisore)	30,000.00	31,500.00	31,600.00
50405	Kompensimi për shfrytëzimin e hapësirës publike: (Kompensimi për objektet montuese- de montuese, për panot reklamuese dhe për hapësirat publike)	36,952.00	37,000.00	37,050.00
50408	Qiraja: (Qiraja për shfrytëzimin e banesave nga programi i banimit social)	13,150.00	14,000.00	14,100.00
	Propozim - Taksat komunale nga trajtimi i ndërtimeve pa Leje – legalizimi i objekteve	41,000.00	42,000.00	42,050.00
9	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	20,000.00	20,500.00	20,500.00
	Të hyrat nga kultura, rinia dhe sportet	20,000.00	20,500.00	20,500.00
	Dënimet në trafik-direkt nga MF-i		-	-
	Te hyrat nga Gjykata		-	-
I.	TOTALI I ADMINISTRATËS KOMUNALE	3,068,258.00	3,650,028.00	3,922,467.00
II.	ARSIMI	250,000.00	251,000.00	251,000.00
III.	SHENDETËSIA	60,000.00	60,143.00	60,200.00
	SUB TOTALI I + II + III	3,378,258.00	3,961,171.00	4,233,667.00
IV.	Participimet e qytetarëve dhe të hyrat tjera etj.		-	-
	SUB TOTALI I + II + III+IV+V	3,378,258.00	3,961,171.00	4,233,667.00

Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2021-2023

Për të pasur një pasqyrë mbi shpenzimet buxhetore të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike buxhetore, në tabelën vijuese po paraqesim trendët historike të shpenzimeve për periudhën e dy viteve të kaluara 2017, 2018, dhe buxhetin aktual 2019, me ç'rast mund të shihen shumat e mjeteve të shpenzuara buxhetore sipas destinimeve dhe pozicioneve buxhetore.

Tabela nr. 4. Trendët historike të financimit sipas strukturës ekonomike për Komunën e Gjakovës 2018-2020.

	Komuna e Gjakovës	2018 (Shpenzuar)	2019 (Shpenzuar)	2020 (Aktual)
1	Paga dhe mëditje.	13,252,490.92	13,599,827.88	14,033,983.00
2	Mallra dhe shërbime	2,234,274.89	2,834,452.75	3,035,875.00
3	Shpenzime komunale	549,083.33	579,693.17	586,800.00
4	Subvencione dhe transfero	459,572.71	482,643.78	510,500.00
5	Shpenzime kapitale	6,613,965.16	8,130,228.64	7,145,143.00
	Rezerva Komunale			2,019,846.00
	Totali :	23,109,087.01	25,626,846.22	27,332,147.00
	Numri i stafit	2238	2238	2252

Propozimi i financimit të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për periudhën: 2021 – 2023 është si në tabelën 5.

Tabela 5. Kufijtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të vlerësuara për Financim për Komunën e Gjakovës: 2021 – 2023


	Komuna e Gjakovës	2021 Vlerësuar	2022 Vlerësuar	2023 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	14,150,978.00	14,190,035.00	14,260,985.00
2	Mallra dhe shërbime	3,240,000.00	3,382,558.00	3,320,024.00
3	Shpenzime komunale	586,800.00	596,026.00	620,860.00
4	Subvencione dhe transfere	550,500.00	586,645.00	621,153.00
5	Shpenzime kapitale	7,802,302.00	11,100,389.00	11,844,939.00
	Totali :	26,330,580.00	29,855,653.00	30,668,031.00
	Numri i stafit	2252	2252	2252

SQARIM - Shpërndarja e Buxhetit komunal për periudhën : 2021 – 2023, siç shihet edhe në tabelën e lartshënuar, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, është bërë konform limiteve buxhetore të përcaktuara me Qarkoren e dytë buxhetore 2021/02, të datës 10.08.2020 dhe Qarkoren e tretë të datës 14.09.2020 të lëshuar nga ana e MF-së.

Struktura e Buxhetit për vitin 2021

Paga dhe mëditje	14,150,978.00	53.74%
Mallra dhe shërbime	3,240,000.00	12.31%
Shpenzime komunale	586,800.00	2.23%
Subvencione	550,500.00	2.09%
Investime kapitale	7,802,302.00	29.63%
TOTALI	26,330,580.00	100.00%

Stuktura e buxhetit për vitin 2021



Në tabelat e mëposhtme gjeni të bashkangjitur **tabelat kumulative – tabelat e kufinjëve buxhetorë –për vitet 2021 – 2023** sipas Drejtorive Komunale:

Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2021

Kodi	Programet	Nr. Pun.	2021 Paga dhe shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	16	125,000.00	80,000.00		20,000.00		225,000.00
163/16316	Aministrata dhe Personel	58	310,000.00	380,000.00	70,000.00		125,000.00	885,000.00
166/16631	Inspektimet	24	150,064.00	80,000.00				230,064.00
167/16780	Prokurimi	6	38,800.00	10,000.00				48,800.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komunal		120,000.00	20,000.00				140,000.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	32	182,683.00	76,500.00			502,949.00	762,132.00
180/18016	Shërbimet Publike - Inf	13	81,700.00	650,000.00	150,000.00	20,000.00	4,411,404.00	5,313,104.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspek	55	360,000.00	75,000.00	18,000.00		80,000.00	533,000.00
195/19580	Zyra Komunale për Kor	5	28,708.00	20,000.00		20,000.00		68,708.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Zh	17	85,000.00	22,500.00	1,000.00	100,000.00	290,000.00	498,500.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	72,500.00	40,000.00		100,000.00	326,000.00	538,500.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	107,230.00	50,000.00	10,000.00		800,000.00	967,230.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe	18	111,751.00	30,000.00			100,000.00	241,751.00
730	Shëndetësia dhe Mirëq	359	2,653,323.00	360,000.00	60,000.00	60,000.00	280,000.00	3,413,323.00
73025	Administrata	6	40,065.00	20,000.00				60,065.00
73950	Shërbimet e Shëndetës	353	2,613,258.00	340,000.00	60,000.00	60,000.00	280,000.00	3,353,258.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	109,919.00	40,000.00	12,000.00	5,000.00	10,000.00	176,919.00
850	Kultura, Rinia dhe Spor	47	301,251.00	140,000.00	60,000.00	175,500.00	121,949.00	798,700.00
85016	Shërbimet Kulturore	24	176,035.00	102,050.00	50,000.00	123,000.00	111,949.00	563,034.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	7,467.00	10,000.00		10,000.00	10,000.00	37,467.00
85175	Teatri	22	117,749.00	27,950.00	10,000.00	42,500.00		198,199.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1553	9,313,049.00	1,166,000.00	205,800.00	50,000.00	755,000.00	11,489,849.00
92080	Administrata	12	77,000.00	470,000.00	18,000.00	50,000.00	755,000.00	1,370,000.00
92510	Arsimi parashkollor	77	446,000.00	95,000.00	27,000.00			568,000.00
93450	Arsimi fillor	1134	6,720,049.00	312,800.00	88,300.00			7,121,149.00
94650	Arsimi i mesëm	330	2,070,000.00	288,200.00	72,500.00			2,430,700.00
TOTAL		2252	14,150,978.00	3,240,000.00	586,800.00	550,500.00	7,802,302.00	26,330,580.00

Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2022

Kodi	Programet	Nr. Pun.	2022 Paga dhe shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	16	125,000.00	82,000.00		24,145.00		231,145.00
163/16316	Aministrata dhe Personeli	58	320,000.00	380,000.00	75,000.00		195,000.00	970,000.00
166/16631	Inspektimet	24	150,064.00	82,000.00				232,064.00
167/16780	Prokurimi	6	38,800.00	10,000.00				48,800.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komunal		120,000.00	20,000.00				140,000.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	32	182,683.00	77,000.00			509,676.00	769,359.00
180/18016	Shërbimet Publike - Inf	13	81,700.00	655,886.00	156,226.00	22,000.00	5,940,000.00	6,855,812.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspek	55	360,000.00	80,000.00	18,000.00		250,000.00	708,000.00
195/19580	Zyra Komunale për Kor	5	28,708.00	22,000.00		22,000.00		72,708.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Zh	17	85,000.00	26,000.00	1,000.00	110,000.00	340,000.00	562,000.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	72,500.00	42,000.00		110,000.00	180,000.00	404,500.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	107,230.00	55,000.00	10,000.00		1,000,000.00	1,172,230.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe	18	111,751.00	35,000.00			110,000.00	256,751.00
730	Shëndetësia dhe Mirëd	359	2,682,380.00	370,000.00	60,000.00	66,000.00	1,800,713.00	4,979,093.00
73025	Administrata	6	40,065.00	20,000.00				60,065.00
73950	Shërbimet e Shëndetës	353	2,642,315.00	350,000.00	60,000.00	66,000.00	1,800,713.00	4,919,028.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	109,919.00	43,000.00	10,000.00	5,000.00	10,000.00	177,919.00
850	Kultura, Rinia dhe Spor	47	301,251.00	142,950.00	60,000.00	177,500.00	140,000.00	821,701.00
85016	Shërbimet Kulturore	24	176,035.00	105,000.00	50,000.00	125,000.00	130,000.00	586,035.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	7,467.00	10,000.00		10,000.00	10,000.00	37,467.00
85175	Teatri	22	117,749.00	27,950.00	10,000.00	42,500.00		198,199.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1553	9,313,049.00	1,259,722.00	205,800.00	50,000.00	625,000.00	11,453,571.00
92080	Administrata	12	77,000.00	470,000.00	18,000.00	50,000.00	625,000.00	1,240,000.00
92510	Arsimi parashkollor	77	446,000.00	95,000.00	27,000.00			568,000.00
93450	Arsimi fillor	1134	6,720,049.00	312,800.00	88,300.00			7,121,149.00
94650	Arsimi i mesëm	330	2,070,000.00	381,922.00	72,500.00			2,524,422.00
TOTAL		2252	14,190,035.00	3,382,558.00	596,026.00	586,645.00	11,100,389.00	29,855,653.00

Tabela 6. Kufijtë buxhetor sipas drejtorive për vitin 2023

Kodi	Programe	Nr. Pun.	2023 Paga dhe shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime Kapitale	TOTAL
160/16016	Zyra e Kryetarit	16	125,000.00	81,000.00		28,653.00		234,653.00
163/16316	Aministrata dhe Personeli	58	320,000.00	380,000.00	86,060.00		200,000.00	986,060.00
166/16631	Inspektimet	24	150,064.00	81,000.00				231,064.00
167/16780	Prokurimi	6	38,800.00	10,000.00				48,800.00
169/16916	Zyra e Kuvendit Komunal		120,000.00	20,000.00				140,000.00
175/17516	Buxhet dhe Financa	32	182,683.00	50,000.00			4,592,426.00	4,825,109.00
180/18016	Shërbimet Publike - Inf	13	81,700.00	624,786.00	170,000.00	25,000.00	2,450,000.00	3,351,486.00
180/18420	Zjarrfikësat dhe Inspek	55	360,000.00	80,000.00	18,000.00		150,000.00	608,000.00
195/19580	Zyra Komunale për Kor	5	28,708.00	22,000.00		25,000.00		75,708.00
470/47016	Bujqësi, Pylltari dhe Zh	17	85,000.00	24,500.00	1,000.00	120,000.00	390,000.00	620,500.00
480/48016	Zhvillimi Ekonomik	12	72,500.00	42,000.00		120,000.00		234,500.00
650/65080	Shërbimet Kadastrale	19	107,230.00	54,500.00	10,000.00		1,500,000.00	1,671,730.00
660/66385	Planifikimi Urban dhe	18	111,751.00	34,636.00			65,000.00	211,387.00
730	Shëndetësia dhe Mirë	359	2,703,323.00	370,000.00	60,000.00	70,000.00	1,804,092.00	5,007,415.00
73025	Administrata	6	40,065.00	20,000.00				60,065.00
73950	Shërbimet e Shëndetës	353	2,663,258.00	350,000.00	60,000.00	70,000.00	1,804,092.00	4,947,350.00
755/75576	Shërbimet Sociale	18	109,919.00	43,000.00	10,000.00	5,000.00	10,000.00	177,919.00
850	Kultura, Rinia dhe Spor	47	301,251.00	142,950.00	60,000.00	177,500.00	128,421.00	810,122.00
85016	Shërbimet Kulturore	24	176,035.00	105,000.00	50,000.00	125,000.00	113,421.00	569,456.00
85056	Përkrahja e rinisë	1	7,467.00	10,000.00		10,000.00	15,000.00	42,467.00
85175	Teatri	22	117,749.00	27,950.00	10,000.00	42,500.00		198,199.00
920	Arsimi dhe Shkenca	1553	9,363,056.00	1,259,722.00	205,800.00	50,000.00	555,000.00	11,433,578.00
92080	Administrata	12	77,000.00	470,000.00	18,000.00	50,000.00	555,000.00	1,170,000.00
92510	Arsimi parashkollor	77	446,000.00	95,000.00	27,000.00			568,000.00
93450	Arsimi fillor	1134	6,770,056.00	312,800.00	88,300.00			7,171,156.00
94650	Arsimi i mesëm	330	2,070,000.00	381,922.00	72,500.00			2,524,422.00
TOTAL		2252	14,260,985.00	3,320,094.00	620,860.00	621,153.00	11,844,939.00	30,668,031.00

PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)

Është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financim të zbatimit të Planeve Zhvillimore si dhe drejtimit të Investimeve Kapitale Publike.

Komunat në Republikën e Kosovës kanë rol qendror në caktimin e prioriteteve të investimeve kapitale dhe në aranzhimin e investimeve lokale përmes mekanizmave të cilat i kanë në dispozicion. Kjo mund të përfshijë gjenerimin e të hyrave lokale, vjeljen e taksave dhe tarifave, zhvillimin e partneriteteve publike-private, aranzhimin e ndarjes së drejtë të projekteve kapitale dhe borxheve.

Kryetari i Komunës së bashku me Kuvendin Komunal si organ legjislativ dhe Komiteti për Politikë dhe Financa janë përgjegjës për përgatitjen e buxhetit i cili përfshinë programin e investimeve kapitale dhe buxhetin.

Programi Komunal për Investime Publike në masë të duhur ka marrë parasysh kërkesat – propozimet e Drejtorive komunale (Programeve buxhetore) – Projektet sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2021 / 2023.

Sipas vlerësimeve të shpenzimeve totale buxhetore - investimet kapitale për vitin 2021 janë në vlerën 7,802,302.00 € nga vlera totale e buxhetit të Komunës për vitin 2021.

Ndërsa për vitin 2022 mbetet shuma 11,100,389.00 € për shpenzimet kapitale dhe për vitin 2023 shuma prej 11,844,939.00 €, kufij këta të përcaktuar me limitet buxhetore sipas Qarkores së dytë Buxhetore nr. 2021/02, të MF për Komunën e Gjakovës për periudhën: 2021 – 2023.

Bashkangjitur në këtë projekt buxhet komunal është edhe lista e projekteve kapitale sipas KAB-it Komunal për vitet 2021 – 2023 sipas Drejtorive Komunale: